



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.02.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për nxitjen e punësimit”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Klodiana Spahiu, Bardh Spahia, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Nuri Belba, Floida Kërpaçi, Halim Kosova, Grida Shqina, Orjola Pampuri, Roland Xhelilaj, Lindita Metaliaj dhe Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Flamur Golemi, Klotilda Bushka, Vangjel Tavo.

Të ftuar:

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave

Genta Prodani – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit meqëqëse plotësohet kuorumi.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin në parim i projektligjit “Për nxitjen e punësimit”.

Të pranishme janë: zonja Dajna Sorensen, zëvendësministre Ekonomisë dhe Financave, dhe zonja Genta Prodani, përgjegjëse sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Sekretaria, kur është njoftuar ministria?

Joana Bitri – Sapo është bërë kalendari.

Petrit Vasili – Ashtu siç ramë dakord para 10 ditësh, me bërjen e kalendarit operativ të punës së komisionit, ministria përkatëse është njoftuar.

Unë jam i detyruar të shpreh shqetësimin tim, pasi, siç e dini ky ligj risillet në komision, është shqyrtuar, ka ardhur, por është lënë në mes muaj më parë, pra që në sesionin e pranverës të një viti më parë. Për këtë ligj është rimiruar një draft nga qeveria, ne edhe atëherë kemi pasur të njëjtën problematikë, madje kemi kërkuar që ligjet, ashtu siç e kërkon Rregullorja, të vijnë dhe të mbrohen nga ministrat. Dua të di: cilat janë arsytet që ministrja nuk vjen, meqenëse ka 10 ditë që është njoftuar. Pra, sapo komisioni ka miratuar kalendarin, ajo është njoftuar për ditën dhe zhvillimin e takimit. Praktikisht, për të qenë të hapur me komisionin, që ditën që këto kompetenca janë marrë nga ministrja përkatëse, kështu ka ndodhur edhe me ministrin që ka qenë më parë, por, për fat të keq, kështu vazhdon edhe me ministren që ka ardhur, nuk është paraqitur asnjëherë në këtë komision për këtë sferë të fushës së veprimtarisë, e cila është marrë përsipër nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Nuk ma do mendja që të mos jemi të një mendimi i gjithë komisioni, pasi, edhe kur do të bëhej struktura dhe do të paraqitej, u kërkuar me insistim gati 1 vit e gjysmë nga komisioni, por nuk ka mundur kurrë të ketë një komunikim me titullarin, ndonëse kërkesat kanë qenë insistuese. Po insisto, sepse një projektligj, i cili qëndron pezull vjen për një kohë të gjatë, u kthye mbrapsht, u ribë për të qenë në rregull dhe i dhamë ministrit të gjithë kohën e duhur që të kishte mundësi të organizonte kohën dhe axhendën. Nuk ka pasur asnjë kërkesë eventuale për një impenjim të ministrit, që të shihnim mundësinë për një orë apo një datë tjetër. Për shembull, siç ka ndodhur me Ministrinë e Shëndetësisë që ka bërë të mundur pjesëmarrjen e ministres. Por prej 1 viti e gjysmë, që nga hapja e Kuvendit ka kompetencë, siç është çështja e punësimit, ka kaluar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, por në mënyrë kategorike ministri, titullari nuk ka marrë pjesë në asnjë nga mbledhjet e komisionit. Besoj se ky është një rast unik, i paparë dhe i padëgjuar, që kurrë, në 1 vit e gjysmë, të mos të frekuentojë komisionin, me të gjitha nismat

e shumta që kanë pasur të bëjnë me programet e qeverisë, buxhetet, projektligjet, ndryshmet e strukturave dhe plot e plot gjëra të tjera. Kështu që, mua më duket një anormalitet i jashtëzakonshëm dhe dua të di...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e mbarova pyetjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Çfarë mendimi kemi ne?!

Petrit Vasili – Jo, po pres mendimin Ministrisë së Financave. Ti nuk ke mendim, mendimin e kanë ata që janë të ftuar.

Klodiana Spahiu – Po e marr fjalën për procedurë.

Petrit Vasili – Zonjë, të mbaroj unë.

Duhet të marr unë një herë përgjigje nga ministria, pastaj mund ta merrni fjalën për procedurë.

Klodiana Spahiu – Nuk mund ta merrni përgjigjen nga ministria, sepse ajo është zëvendësministria që mbulon sektorin e punësimit dhe në çdo...

Petrit Vasili – Prit të mbaroj pyetjen.

Zonja zëvendësministre, a keni një informacion pse ministria e kishte të pamundur që të ishte këtu, të paktën si shkak formal?

Dajna Sorensen – Në Ministrinë e Financave, në pozicionin që unë mbaj, jam në mënyrë të drejtpërdrejtë, përgjegjëse për çështjet e punësimit. Mendoj se mund ta prezantoj këtë ligj dhe ta mbroj mjaft mirë, sepse njoh në çdo detaj teknik dhe politik të tij.

Petrit Vasili – Pyetjen e kisha ndryshe, por po e ripërsëris. Duhet të dini se komisioni, në bazë të Rregullores, kërkon titullarët. Titullari kushtetuesi i ministrisë nuk jeni ju, titullari politik, i votëbesuar në Kuvend është ministri. Këtë nuk e them unë, këtë e thonë Kushtetuta dhe Rregullorja.

Në rastin konkret, ju vini dhe përfaqësoni për pamundësi të ministrit jo thjesht për një kompetencë më të lartë. Këtë e përcakton Rregullorja. Si rregull, ky është një rregull formal, që nuk ka vend për interpretime, jepet një arsye, ne mund të jemi subjektivë dhe mund ta quajmë arsyen jobindëse, por ju e quani bindëse dhe thoni: “për këtë arsye ministria e ka të pamundur”, ndërkohë delegohet zëvendësministria, e cila njih fushën dhe vazhdon punën. Pra, ju merrni një atribut për pamundësinë e ministrit. Kuvendi nuk komunikon me zëvendësministrat, komunikon me ministrat, por gjithmonë në mirëkuptim ne krijojmë hapësirën për ta bërë ju, në rastin konkret, apo një zëvendësministër, kudo që ndodhet, në një ministri tjetër.

Pyetja ime është vetëm a ka një shkak objektiv mungesa ministres? Sepse në rast se ju më thoni se nuk ka, dhe ministrja rri në zyrë, ndërkohë për institucionin që e ka votëbesuar, që është parlamenti, nuk ka kohë të merret, kjo është çështje që më pas nuk ju takon juve. Unë po ju pyes vetëm, a ka një shkak të tillë? Pra, e ka të pamundur, ndodhet jashtë, ka një mbledhje të Këshillit të Ministrave, ka një arsye, apo nuk ka? Duhet thënë kjo dhe më pas mund të vazhdojmë së bashku të zhvillojmë dëgjuesën. Kjo nuk është çështje as për polemikë dhe as për gjë. Ky është një element formal zyrtar, i cili sqarohet në fillim dhe ecet përpara, por ka nevojë për një sqarim. Kemi pasur raste, kur kemi lëvizur orën e caktuar, pasi është thënë se ministri përkatës ndodhet në mbledhje të Këshillit të Ministrave, ose, në rastin konkret, ministria juaj, në seancën e fundit plenare, ishte thirrur për pyetje, por tha se ishte në një vizitë zyrtare me Kryeministrin jashtë vendit e kishte të pamundur dhe seanca e pyetjeve është shtyrë për një seancë tjetër, por dha një shkak formal. Pyetja ime është: a ka një shkak formal, a ka një arsye? Në qoftë se nuk e dini, thoni: “nuk e di”.

Dajna Sorensen – Me sa di unë, ka angazhime të tjera në këtë moment, konkretisht nuk e di se çfarë.

Klodiana Spahiu – Ky është një projektligj shumë i rëndësishëm, i cili, ashtu siç e thatë edhe, ju ka kohë që ka ardhur në komision, fillimisht si një ndryshim, pastaj u propozua nga ministria që do të vijë një ligj i ri. Kur kemi bërë mbledhjen për kalendarin...

Petrit Vasili – U tërhoq ministria, t’i referojmë gjërat tamam, sepse pati disa gjëra, të cilin ishin inkoherenca të forta... Meqenëse e morët përsipër këtë pjesë, informojeni komisionin.

Klodiana Spahiu – Ju e informuat komisionin me detaje.

Petrit Vasili – Jo, për këtë çështje, meqenëse na çove në një çështje tjetër...

Klodiana Spahiu – Ju lutem, meqenëse është një ligj kaq i rëndësishëm dhe ne e vendosëm bashkë në kalendar, që do ta...

Petrit Vasili – Jo, e vendosi seanca plenare.

Klodiana Spahiu – E vendosi seanca plenare dhe bashkërisht vendosëm që do të bëhet të mërkurën. “Edhe pse është mbledhje qeverie, ne do ta bëjmë, sepse kemi për ta diskutuar vetëm në parim” kjo ka qenë fjala juaj. Madje ju kërkuat ta shqyrtonin edhe komisionet e tjera: Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. Në qoftë se mbani mend, në diskutim, unë ju kërkova, meqenëse do ta diskutojnë edhe komisionet e tjera, që të mos bëjmë të mërkurën, meqenëse të mërkurën është edhe mbledhja e qeverisë. Për këtë që po ju them janë edhe procesverbalet, sepse e kërkova vetë shtyrjen e këtij projektligji për arsye që edhe ne të kishim kohën e duhur për të parë të gjitha vërejtjet që kishin ardhur, në

mënyrë që mund t'i reflektonim dhe t'i diskutonim me përfaqësuesit e ministrisë. Ju nuk ishit dakord që mbledhja të shtyej.

Petrit Vasili – Kjo ka 6 javë që është përfshirë në program.

Klodiana Spahiu – Ju lutem, zotëri kryetar, a mundet të flasim me radhë?! Ju folët, tani, ju lutem! Ju kërkoni një gjë...

Petrit Vasili – Mirë, se flas përsëri.

Klodiana Spahiu – Mirë flisni, sepse ne nuk po merremi me çështjen, po merremi me gjëra...

Petrit Vasili – As ti nuk po merresh fare me çështjen.

Klodiana Spahiu – Unë po ju them që nuk duhet të procedojmë...

Petrit Vasili – Ky është një vendim i marrë, çfarë duhet të diskutojmë?

Klodiana Spahiu – Vendimi është marrë dhe ditën që është marrë vendimi, ja ku jemi të gjithë ne anëtarët, ja ku i ke edhe kolegët e opozitës...

Petrit Vasili – Ka 10 ditë që është njoftuar ministria.

Klodiana Spahiu – Ju kam kërkuar, meqenëse është e mërkurë dhe ka mbledhje qeverie, që ne ta spostojmë, sespe ne nuk bëhemi dot gati për në seancën plenare në datën 22.

Ju ratë dakord vetë, për ditën e mërkurë, nuk ka rëndësi, sepse do të diskutohet vetëm në parim. Në qoftë se ne zbardhim procesverbalin dhe gjendet vetëm një fjali e juaja, që ju si kryetar komisioni keni të drejtën të kërkoni ministren ose ministrin respektiv...

Petrit Vasili – Nuk e kam unë, e ka Rregullorja.

Klodiana Spahiu - Po ju them Rregullorja e ka, “ministri ose zëvendësministri”, sepse nuk është hera e parë që ne po diskutojmë një projektligj dhe mos ngulni këmbë për një gjë që është normale.

Zonja Sorensen, në mënyrë të vazhdueshme, që kur ka marrë detyrën, është paraqitur në këtë komision vetëm...

Petrit Vasili – Po, sepse nuk vjen asnjëherë ministri, për asnjë çështje.

Klodiana Spahiu – Të lutem, më lër të mbaroj!

Petrit Vasili – A është e vërtetë që nuk ka ardhur kurrë ministri? Thuaja komisionit, pra një herë të vetme thuaj një të vërtetë.

Klodiana Spahiu – Unë do t'i them të gjitha të vërtetat. Ju i thatë të vërtetat, tani më lini mua, në variantin tim, të them të vërtetën.

Petrit Vasili – Thuaj të vërtetën, që nuk ka ardhur kurrë ministri këtu.

Klodiana Spahiu – Unë them të vërtetën e procesverbalit. Ju lutem, më lini ta mbaroj mendimin!

Petrit Vasili – Fol, se nuk po të pengon njeri.

Klodiana Spahiu – Pse mërzitesh kaq shumë nga fjala ime?

Petrit Vasili – Sepse as mua nuk më le të mbaroj.

Klodiana Spahiu – Si nuk e mbarove? Jo, ke mbaruar.

Tani po ju them edhe një herë, zonja Sorensen, ka mbuluar politikat e punësimit dhe në çdo marrëveshje që është bërë për këtë punë ka qenë prezent...

Petrit Vasili – Lëreni avokatinë, sepse nuk ka nevojë për avokatinë tënde. E bën ministria vetë avokatinë e punëve të saj, nuk të ka lënë ty të bësh avokatin.

Klodiana Spahiu – Po çfarë kërkon? Ju kërkoja shtyrjen e komisionit, sepse po i kaloni të gjitha caqet.

Petrit Vasili – Mos më tregoni mua caqet. Ne po kërkojmë sipas Rregullores, të vijë ministri, sepse nuk ka ardhur asnjëherë.

Klodiana Spahiu – Për ta bërë mbledhjen në orën 09:00 nuk pranon, mund të më thuash një arsye? Pse nuk e bërë mbledhjen në orën 09:00?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Donim vetëm ta afronim mbledhjen dhe t'i kërkonim ministres të ishte prezent, sepse ajo nuk mund të ishte as në orën 10:00 dhe as në orën 11:00.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk bëj fare debat, sepse nuk ka arsye për debat në këtë rast. Kush na dëgjon, na bën të gjithëve fajtorë. Po ju them në procesverbal nuk e kemi...

Petrit Vasili – Jo, të bën ty fajtorë, jo neve. Pse jemi ne fajtorë?

Klodiana Spahiu – Nuk e kemi kërkuar.

Bardh Spahia – Pse nuk vjen ministrja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Ministrja nuk mund të vijë të mërkurën. Unë ju kërkoja që ta shtyjmë mbledhjen e ditës së mërkurë...

(Diskutime pa mikrofon)

E shtyjmë mbledhjen, pse shqetësoheni?! Shtyjmë mbledhjen, shkojmë edhe ne tek ata njerëzit që na kanë vdekur, sepse nuk ka ndonjë gjë! Nuk është ministrja, e shtyjmë mbledhjen.

Petrit Vasili – Mbaruat? Në rregull, e kuptuam.

Klodiana Spahiu - Do të dilni tek orari?!

Petrit Vasili - Nuk do të më tregosh ti se çfarë do të them unë. Më thoni: “Përshëndetje kolegë, brenda mundësive, kërkoj mirëkuptimin që mbledhjen ta fillojmë nesër në orën 09:00”, a ke dhënë ndonjë arsye pse? Ky është njoftimi.

Klodiana Spahiu – Pse duhet të themi edhe arsyen kur më vdes njeri?!

Petrit Vasili – Nuk kisha asnjë arsye. Ti deri tani thua që thashë për ministren. Ku është njoftimi që më ke bërë, i cili nuk ka asnjë arsye. Meqenëse, po i kthehemi kësaj pune, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, në jo pak raste, por në rutinë, kjo nuk është një rrethanë e dëgjuar, por është një rrethanë e përjetuar, për pak muaj edhe unë kam qenë anëtar i Këshillit të Ministrave, për rrethana të caktuara qeveria, në jo pak raste, përfaqësohet në mbledhjen e Këshillit të Ministrave me zëvendësministra, sikurse përfaqësohet dhe drejtohet edhe nga zëvendëskryeministri, pa qenë Kryeministri. Kjo që ti thua është një rrethanë tërësisht fiktive. Duke çmuar impenjimet ministri zgjedh se cili është impenjimi më madhor.

Në rastin konkret, ky komision kurrë, në mënyrë absolute, nuk është frekuentuar, pra nuk është paraqitur një herë të vetme ministri. Në rekorde të komisionit është unike, dhe kësaj nuk mund t’i bëni avokati. Pra, ministri përkatës nuk është paraqitur asnjëherë në komisionin, që ka fushën e veprimtarisë, ky është rast që nuk ka të dytë dhe as ti nuk ke të dytë në kaq vite që je në komision, së pari.

Së dyti, ne kemi pasur mirëkuptim e pafund për 1 mijë nisma të tjera, ky ligj, ka një histori, për mendimin tim, jo pozitive, sepse ishte një ligj që erdhi në Kuvend, u miratua në qeveri, ne këtu paraqitëm vërejtje dhe u tërhoq, në prezencën tuaj, nga vetë ministria, sepse ishte një situatë, e cila në ato parametra ishte me kundërthënie të mëdha dhe të papranueshme për vetë ministrinë. Aq më tepër që rivihej, ishte në minimumin e dinjitetit të përfaqësimit zyrtar, pra meqenëse kemi pasur një histori kaq të gjatë, 7 muaj tërheqje ligji, rimiratim për herë të dytë në qeveri, rast unik edhe ky, që një ligj qeveria e rrëzon dhe e ribën, e risjell në Kuvend në një version krejtësisht të ri. Për të gjitha këto rrethana minimalisht ishte e domosdoshme që të vinte ministri, edhe siç themi ne nga anët tona, për të prishur syrin e keq, të vinte një herë në një komision parlamentar, në të cilin ka një sërë varësie të rëndësishme, siç është punësimi. Çfarë ka këtu për të diskutuar? Kurse tabuja e qeverisë, absolutisht nuk është tabu. Unë kam qenë vetë në atë Këshill të Ministrave, kam pasur 7 zëvendësministra dhe këta e dinë. Pikërisht, për arsye të caktuara, ministri ka qenë në inaugurimin e një objekti të caktuar në një rreth të Shqipërisë, puna e tij, dhe në mbledhjen e Këshillit të Ministrave ka çuar zëvendësministrin.

Kur ka mbledhje komisioni parlamentar, ai nuk mund ta lërë mbledhjen e Këshillit të Ministrave, ndërsa mbledhjen e Këshillit të Ministrave mund ta lërë, sepse është në një aktivitet

tjetër! Kjo nuk shkon, sepse një ministër institucionin më të lartë të llogaridhënies ka parlamentin, nuk ka tjetër. Në qeveri është brenda një skuadre ekzekutive, kjo nuk diskutohet, është pjesë e atyre punëve që bën atje, ndërsa si nivel llogaridhënie nuk ka institucion tjetër përveç parlamentit, pra komunikimit me ne. Kjo që po them unë nuk ka vend as për të bërë polemikë, as për të bërë politikë dhe as për t'i bërë alibi. Ne këtu nuk mund të jemi të ndarë për këtë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithmonë e kemi kërkuar ministrin, madje...

(Zonja Spahiu ndërhyr pa mikrofon.)

Ku është problemi këtu nëse ngremë një çështje apo ndajmë një shqetësim?

Klodiana Spahiu - Zoti kryetar, shqetësimin e ndamë.

Petrit Vasili – Kini durim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Nuk është ministri, dakord, është gabimi ynë! A doni ta bëjmë sot mbledhjen?

Petrit Vasili – Çfarë keni ti me këtë gjë?!

Klodiana Spahiu – Keni që në fillim të mbledhjes që përsërisni 20 herë të njëjtën gjë. Kërkoni, ministrin, nuk është, është zëvendësministria.

Petrit Vasili – Ti nuk ke durim të dëgjosh argumentimet.

Klodiana Spahiu – Çfarë argumentimi?! Kam gjysmë ore që ju dëgjoj juve.

Petrit Vasili – Mbase nuk i kupton të gjitha argumentimet që bëj unë, kështu që nuk ka ndonjë keqkuptim!

Klodiana Spahiu – Ju lutem, a mund të vazhdojmë? Në qoftë se ju nuk doni ta bëni mbledhjen me zëvendësministren, a mund ta lëmë për një ditë tjetër, ku të jetë prezent ministri, apo do të procedojmë me zëvendësministren? E kuptuam shqetësimin tuaj dhe jemi dakord me shqetësimin tuaj, por duhet të pranoni këtë gjë: nuk e kemi vendosur dhe nuk e kemi kërkuar ne, siç kemi kërkuar në rastet me ministren e Shëndetësisë, që sot duhet të jetë ministri. Ju e dini shumë mirë që projektligji...

Petrit Vasili – Këto gjëra që thua ti janë fëmijërore.

Klodiana Spahiu - Fëmijërore?! Po si janë fëmijërore?! Në historinë parlamentare kështu ndodh.

Petrit Vasili – Ligji është atribut i titullarit që vjen e mbron.

Klodiana Spahiu - Në rregull, sot nuk është titullari.

Petrit Vasili – Urdhëroni, zonja Bode!

Thoni një argumentim ndryshe nga kjo, ose thoni se jeni dakord që të mos vijë asnjëherë ministri këtu!

Më bindni për këtë punë, sepse jam i lumtur nëse më bindni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Kam një propozim, le të marrim një vendim: a do të vazhdojmë me zëvendësministren, apo do ta shtyjme seancën, me kërkesën që të jetë prezente ministrja patjetër. Debatet e tjera më duken pa vlerë.

Bardh Spahia – Zoti kryetar, mua më vjen keq që shqetësimet, më se të drejta dhe më se normale të kryetarit të komisionit dhe të përfaqësuesve të opozitës, në lidhje me mungesën e ministrit të Ekonomisë në një vit e gjysmë në këtë komision nuk janë marrë asnjëherë parasysh. Kolegët e maxhorancës tentojnë ta mbulojnë këtë fakt me justifikime të paqena.

Është akoma edhe më e turpshme të dëgjohet në këtë komision edhe nga përfaqësuesja e ministrisë, zëvendësministrja, edhe nga kolegja e maxhorancës justifikimi (të paktën ashtu siç e kuptova unë) për paaftësinë e ministres për të mbuluar këto çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, mos më ndërhyuni, sepse nuk ju ndërhyra!

(Zoti Vasili dhe zonja Spahiu flasin njëkohësisht.)

Këtu u tha se prezenca e zëvendësministres ishte për faktin se ajo është më e përgatitur për shkak se mbulon këto çështje. Domethënë, ministrja nuk ishte kompetente për këto çështje, nuk ishte e aftë të mbulonte ose të mbronte këto çështje në Komisionin e Shëndetësisë. Këtë thatë edhe zëvendësministrja, edhe ju. Ju duhet ta vendosni dhe ta sqaroni: ministrja nuk erdhi për shkak të paaftësisë për të mbuluar këto çështje, apo se kishte një impenjim, të cilin askush, as nga ju të maxhorancës, nuk e di për momentin?!

Zëvendësministrja tha: “Nuk e di nëse ka një impenjim tjetër që mungon”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zëvendësministrja tha: “Unë jam kompetente për këto çështje”, çka nënkupton se nuk është ministrja kompetente për këto çështje, siç e tha edhe kolegja, pak më parë. Kjo më duket një situatë aspak normale.

Zëvendësministrja i ka të gjitha mundësitë, nëse është ekspertja më e mirë e këtyre çështjeve, të shkojë dhe t’ia sqarojë ministres në zyrë, të diskutojë dhe ta informojë ministren, e cila është përfaqësuesja më e lartë e asaj ministrie, dhe më pas ajo të vijë e përgatitur këtu, me të gjithë të tjerët, me informacionin e marrë nga zëvendësministrja. Në rregull? Kështu do të funksiononte në një situatë normale. Justifikimet se nuk është kompetente për këto çështje

ose mund të ketë impenjime të tjera, nuk qëndrojnë aspak, sepse ka 1 vit e gjysmë që nuk ka marrë pjesë në këtë komision qoftë edhe një herë të vetme. Në qoftë se ju duket normale neglizhenca me të cilën përfaqësuesit e ekzekutivit trajtojnë legjislativin, i cili ka detyrë dhe duhet të kontrollojë punën e ekzekutivit, atëherë do të thotë se ne këtu i kemi ngatërruar gjërat. Kam përshtypjen se kjo është edhe me njëfarë tendence, sigurisht edhe në frymën e përgjithshme të mosnjohjes së institucioneve të shtetit.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Urdhëroni!

Arben Kamami – Në qoftë se do të vazhdojmë me të tilla diskutime, nuk mendoj se do të arrijmë në thelbin e problemit, domethënë në shqyrtimin e projektligjit. Mendoj se duhet ta hedhim në votë: a të vazhdojmë me zëvendësministren, apo duhet të anulojmë mbledhjen dhe të presim ministren?

Faleminderit!

Petrit Vasili – Urdhëroni, zonja Kërpaçi!

Floida Kërpaçi – Në fakt, sot do të diskutojmë propozimin e projektligjit për nxitjen e punësimit, një projektligj që duhet të marrë një vëmendje shumë të veçantë. Sot kemi shkelje të Rregullores së Kuvendit, ku ministrja përgjegjëse duhet të ishte këtu, përpara këtij komisioni, sepse e ka detyrim për të ardhur dhe për të dhënë të gjithë arsyetimin e saj dhe të qeverisë për marrjen e kësaj iniciative dhe për të gjithë projektligjin në fjalë, por, në fakt, nuk kjo që bën ministrja është gjë tjetër, veçse neglizhencë.

Nga zonja Sorensen kuptova që, duke qenë se ajo mori kompetencat e njohjes së këtij projektligji, ministrja nuk e njeh këtë projektligj. Atëherë, kush e merr përgjegjësinë për këtë projektligj? Kush do ta marrë përgjegjësinë për projektligjin “Për nxitjen e punësimit”, në qoftë se ministrja përgjegjëse nuk vjen këtu, në bazë të Rregullores së Kuvendit, për të na bërë një paraqitje të këtij projektligji? Jemi në një situatë të paprecedentë, që nuk duhet të ndodhë më në këtë komision dhe ju, si anëtarë të maxhorancës, duhet të tërhiqeni, të distancoheni dhe ta kuptoni po shkelet Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Dua t’ju tërheq vëmendjen edhe për diçka tjetër. Në mbledhjen e mëparshme të Konferencës së Kryetarëve, por edhe në seancën plenare, Kryetari i Kuvendit ka tërhequr vëmendjen, në bazë të shqetësimeve të ardhura jo vetëm nga komisionet që drejtohen nga opozita, për të shuar çdolloj paragjykim në këtë çështje, por edhe nga komisionet që drejtohen nga maxhoranca, për refuzimin sistematik të pjesëmarrjes së ministrave, në zbatim të detyrimeve që ata kanë për t’u paraqitur në Kuvend dhe për të mbrojtur ato nisma ligjore për

të cilat Kuvendi duhet të shprehet me diskutim dhe me votim në seancë plenare. Është kaq e vërtetë, saqë, nisur nga këto shqetësime, ka pasur edhe komunikim me shkrim të Kryetarit të Kuvendit për ministrat, dhe në seancën e fundit plenare ju e keni ndjekur një debat që kemi pasur për prezencën, ka rikonfirmuar pikërisht të njëjtën gjë.

Arsyeja e rimarrjes së kësaj teme është për shkak se ka kaluar çdolloj mase, ajo që quhet tolerancë e mirëkuptuar, lidhur me këtë çështje. Një nga gjërat që u diskutua në mënyrë të prerë ishte që projektligjet, pra që janë nismat madhore të një dikasteri përkatës, janë detyrim politik i ministrave, sepse nëpërmjet tyre bëhet politika e ministrit. Shumë pyetje kanë karakter juridik dhe politik dhe, sigurisht, atributet për të dhënë përgjigje të tilla nuk janë veçse të ministrit, pasi ka situata interpretative, ku, natyrshëm, ministrat nuk mund të futen, nuk mund të japin, kanë kufizimet e tyre dhe për këtë shkak debati mbetet i kufizuar, i cunguar dhe mund të krijohen keqkuptime të panevojshme në debat, sepse nuk kanë atributet politike për ta bërë këtë gjë.

Kështu që, për ta sqaruar njëherë e përgjithmonë, kjo nuk ka qenë ndonjë vërejtje apo kërkesë, e cila bëhet për të krijuar një debat fiktiv, por ka qenë vetëm për të theksuar atë nivel përgjegjshmërie që ka kjo punë dhe për të evituar shpeshherë debate apo shkëmbime mendimesh, të cilat nuk kanë pasur fare lidhje, por për shkak se mbrojtja në nivel më të ulët politik krijon debat, në vend që ta shterojë atë.

Për këtë arsye i qëndrova shumë kësaj pike, aq më tepër që rasti ishte tipik. Nuk mund ta them këtë gjë dhe asnjë nga ne nuk mund ta thotë këtë gjë për Ministrinë e Çështjeve Sociale, me të cilën në jo pak raste kemi pasur debateve për projektligje dhe gjëra të caktuara, por ato janë mbrojtur drejtpërsëdrejti nga ministri. Ministria e dytë ka qenë kjo. Por, ashtu siç e dini, ne kemi kërkuar seancë dëgjimore edhe me Ministrinë e Jashtme për barazinë gjinore e të tjera, por ajo ka refuzua për t'u kryer kjo seancë.

Meqenëse problemi u trash së tepërmi, unë nuk mendoja kurrë, jua them sinqerisht, që për një projektligj me këto probleme (projektligji nuk ka probleme), pra që erdhi dhe u kthye, praktikisht pati probleme përderisa u kthye, u rimor dhe ribë nga e para, do të kishte këtë shkallë përgjegjshmërie për të ardhur dhe për ta mbrojtur dhe për të dhënë një sqarim më të gjerë dhe të gjatë. Ne doni të dinim se cilat ishin gjërat nga të cilat hoqi dorë ministria, me të drejtë, në reflektim nga projektligji i parë, si reflektoi në projektligjin e dytë, pasi në atë kohë ne patëm edhe një komunikim shkresor. Madje pati insistim jo vetëm nga unë, por edhe zonja Spiropali kërkoi që ministri të ishte prezent, madje u mor disa ditë rresht që të gjente mundësinë, por ne nuk mund të shndërrohemi në gjahtarë të ministrave, që aman hajdeni në

komision! Kjo nuk është as në nderin tonë, të gjithëve ne bashkë, përveçse është detyrim i Rregullores, por as mënyrë komunikimi.

Kështu që, unë nuk e di cili është mendimi juaj, por mendoj se, në rast se do të vazhdojmë në diskutimin e këtij projektligji në këtë nivel, ne do të legjitimojmë një formë komunikimi, që komisioni është fakultativ, ministrat, po të duan, vijnë, po të duan, nuk vijnë, po patën kohë, ndonjëherë vijnë, po nuk patën kohë, mund të mbarojë edhe legjislatura dhe mund të mos vijnë kurrë. Kjo do të ishte shumë poshtëruese për komisionin dhe, me thënë të drejtën, unë nuk pajtohem dot me një dimension të tillë.

Kështu që, në rast se ju jeni dakord, unë mendoj ta mbyllim mbledhjen dhe ta shtyjmë projektligjin për një herë tjetër, ku të njoftohet ministrja që të marrë masat për pjesëmarrjen? A jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA